



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 169, datë 29.09.2021**

**PËR  
MIRATIMIN E DELEGIMIT TË FUNKSIONEVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE  
TË FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE  
KOLEKTIVE “ALBSIG INVEST” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, të Rregullores nr. 1, datë 13.01.2011 “Për delegimin e funksioneve të shoqërisë administruese të fondeve të pensioneve”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

**1. Miratimin e delegimit tek shoqëria “Albsig” sh.a., të funksioneve të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive “Albsig Invest” sh.a., si më poshtë:**

- Shërbimet ligjore, përputhshmëria dhe parandalimi i pastrimit të parave të veprimtarisë së administrimit;
- Shërbimet e mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare;
- Shërbimet e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Shërbimet e auditit të brendshëm;
- Shërbimet e marketimit dhe prokurimeve;
- Shërbimet e administrimit të teknologjisë së informacionit.

**2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE**